

# Policia e Kosovës

Rr. Luan Haradinaj, P.N. 10000, Prishtinë, Kosovë

Email: [info@kosovopolice.com](mailto:info@kosovopolice.com)

Web: [www.kosovopolice.com](http://www.kosovopolice.com)

## **POLITIKA E PRIVATËSISË**

Policia e Kosovës (PK) është e përkushtuar për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë tuaj, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-076 për Policinë, Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (i harmonizuar me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të BE-së - GDPR), dhe legjislacionin tjetër në fuqi – cilat zbatohen nga Policia e Kosovës .

Kjo politikë shpjegon në detaje si mbledhim, përdorim, ruajmë, ndajmë dhe fshijmë të dhënat tuaja, duke u bazuar edhe në praktikat dhe standardet evropiane. Ne sigurojmë që të dhënat tuaja trajtohen me konfidencialitet të lartë dhe vetëm për qëllime legjitime policore, duke shmangur çdo përdorim për qëllime jo relevante.

### **1. Kontrolluesi i të Dhënave**

Policia e Kosovës është kontrollues i të dhënave personale (sipas nenit 3, parag. 1.11 të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale). Ne mbledhim dhe përpunojmë të dhëna vetëm për të arritur objektivat legjitime të policisë, si mbrojtja e rendit publik, parandalimi dhe hetimi i krimeve, kontrolli dhe mbikëqyrjen e kufijve dhe ndihma në emergjenca.

Përpunuesit: Vetëm zyrtarë policorë të autorizuar, në pajtim me nenet 3 dhe 16 të Ligjit për Policinë.

Çdo punonjës është i detyruar të zbatojë detyrimin e konfidencialitetit (neni 13 i Ligjit për Policinë dhe nenet 423–425 të Kodit Penal mbi shkeljen e fshehtësisë zyrtare).

Kontakti i Zyrtarit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (ZMDHP) në Policinë e Kosovës është ky: [mdh@kosovopolice.com](mailto:mdh@kosovopolice.com) . ZMDHP është përgjegjës për monitorimin e pajtueshmërisë me ligjin, trajtimin e ankesave dhe bashkëpunimin me Agjencinë për Informim dhe Privatësi (AIP).

Ne sigurojmë që çdo punonjës policor të përpunoj (përdorë) të dhënat personale të qytetarëve në pajtim me ligjin.

## **2. Kategoria e të Dhënave që Mbledhim**

-Të dhëna Personale si: Emër, mbiemër, adresë banimi, numër telefoni, email, datëlindje, numër ID, numër pasaporte, të dhëna biometrike (si gjurmë gishtash ose foto nga hetime), dhe të dhëna nga raportime krimi ose kontrolli i trafikut. Këto mbledhen për të identifikuar individë në kontekste policore, siç parashihet në Nenin 16 të Ligjit për Policinë (identifikimi i personave), të cilat ruhen vetëm për qëllime strikte policore dhe nuk ruhen më gjatë se nevojitet.

- Të dhëna tjera si: IP-adresë nga vizitat në faqen tonë, të dhëna nga CCTV (kamerat e sigurisë publike), kamerat e trupit (body-cams), dhe të dhënat digjitale. Këto mbledhen për të parandaluar krimet dhe për të mbështetur hetimet.

Burimet e mbledhjes: Raportime publike të krimeve, hetime penale, patrullime, bashkëpunime me institucione të tjera (si Prokuroria ose Gjykata), gjopa, kontrolle kufitare ose të dhëna nga partnerë ndërkombëtarë.

Ne nuk mbledhim të dhëna pa bazë ligjore dhe sigurojmë që mbledhja të jetë proporcionale.

## **3. Qëllimet e Përpunimit të të Dhënave**

Ne përpunojmë të dhëna vetëm për qëllime legjitime policore, si:

- Parandalimi, zbulimi dhe hetimi i krimeve.
- Mbrojtja e sigurisë publike, përfshirë edhe trafikun, kontrolli dhe mbikëqyrja e kufijve, (duke përfshirë patrullime dhe CCTV).
- Shërbime administrative, si kontrolli i gjobave të trafikut ose raportimi anonim i krimeve (me garanci konfidencialiteti).
- Zbatimi i vendimeve të Gjyqësorit dhe Prokurorisë
- Analiza statistikore dhe hulumtuese (vetëm të anonimizuara, pa të dhëna personale).
- Bashkëpunimi ndërkombëtar (sipas marrëveshjeve ndërshtetërore).
- Ndihma në emergjencë (si fatkeqësi natyrore apo të shkaktuara nga njeriu).

Ne nuk përdorim të dhëna për qëllime komerciale dhe çdo përdorim është kufizuar në kohë sa më të shkurtër të mundshme për të minimizuar ndikimin në privatësinë tuaj.

## **4. Baza Ligjore për Përpunim**

- Obligim Ligjor: Bazuar në Ligjin për Policinë (p.sh., Neni 31 për ruajtjen e të dhënave kriminale), Kodin Penal dhe Procedurën Penale, Ligjin për Kontrolle dhe Mbikëqyrje të Kufirit shtetërorë, Ligjin për Rendin dhe Qetësinë Publike etj.

- Ushtrimi i autoritetit zyrtar dhe interesi publik: Për detyra policore si mbrojtja e rendit.
- Pëlqim: Për cookies jo-esenciale në faqen tonë ose raportime vullnetare.
- Interesa Vitale: Në emergjenca për të mbrojtur jetën (p.sh., gjatë fatkeqësive).

## **5. Të Drejtat e Subjekteve të të Dhënave**

Ju keni të drejta të plota sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale:

- Të drejtë për qasje në të dhënat tuaja (por me kufizime nëse zbulimi rrezikon hetimet).
- Korrigjim dhe Fshirje: Korrigjoni të dhëna të pasakta ose kërkonte fshirje kur nuk nevojiten më.
- Kufizim dhe Kundërshtim: Kufizoni përpunimin ose kundërshtoni për arsye personale (p.sh., nëse besoni se të dhënat tuaja ruhen pa arsye).

Ushtroni të drejtat tuaja duke kontaktuar ZMDHP-në, por ashtu edhe siç parashihet në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të drejtat tuaja mund të kufizohen kur kjo është e nevojshme për sigurinë shtetërore, mbrojtjen, sigurinë publike, parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale si dhe objektivave të rëndësishme të interesit të përgjithshëm publik të Republikës së Kosovës.

Nëse ju pretendoni se të drejtat tuaja janë shkelur, ju keni të drejtë të paraqitni ankesë pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi, duke vizituar faqen zyrtare të saj në: <https://aip.rks-gov.net> apo përmes postës elektronike [info.aip@rks-gov.net](mailto:info.aip@rks-gov.net)

## **6. Shkëmbimi - Ndarja e të Dhënave me palët e treta**

PK-ja mund të ndajë të dhënat tuaja me Prokurorinë, Gjykata, si dhe institucionet tjera qeveritare bazuar në autorizimet e tyre ligjore. Gjithashtu mund të ndajë të dhënat edhe me organizatat ndërkombëtare bazuar në marrëveshjet ndërkombëtare të bashkëpunimit dhe praktikave të bashkëpunimit ndërkombëtar për qëllime legjitime.

## **7. Ruajtja dhe Siguria e të dhënave**

- Të dhënat ruhen vetëm sa nevojitet dhe siç është e parashikuar me ligjet përkatëse. Pas përfundimit të qëllimit apo të afatit ligjor të njëjtat fshihen apo bëhen anonime.

PK-ja zbaton masa të duhura teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale si: enkriptimi, qasja e kufizuar (vetëm zyrtarë autorizuar), Auditim periodik i sistemeve dhe log-imeve (sipas standardeve ISO 27001), testime të sistemeve etj.

## **8. Të Dhënat e Fëmijëve**

Ne nuk mbledhim të dhëna të fëmijëve nën 16 vjeç pa pëlqim prindëror. Në intervista policore për të mitur, kërkojmë praninë e prindit apo kujdestarit ligjor ose Avokatit.

## **9. Cookies dhe Teknologji të Ngjashme**

- Cookies esenciale lejohen pa pëlqim (login, siguri).
- Cookies jo-esenciale (analitike, preferenca) kërkojnë pëlqim të shprehur.
- Monitorimi me CCTV dhe body-cams bëhet sipas Ligjit për Policinë (neni 25) dhe procedurave operative standarde.

## **10. Monitorimi i Hapësirave Publike përmes CCTV**

Në përputhje me nenin 25 të Ligjit për Policinë, Policia e Kosovës përmes sistemit të video vëzhgimit (CCTV) monitoron hapësira publike për qëllim të sigurisë dhe parandalimit të veprave penale. Regjistrimet ruhen deri në 30 ditë, përveç rasteve hetimore.

Gjithashtu për qëllime policore por edhe për qëllim të transparencës së punës së zyrtarëve policor, disa njësi të PK-së janë të pajisura me kamera të trupit përmes së cilëve përpunojnë të dhëna personale. Këto kamera përdoren sipas procedurës standarde të operimit për përdorimin e këtyre kamerave dhe në përputhje të plotë me legjislacionin.

## **10. Ndryshime në Politikë dhe Kontakti**

Kjo politikë përditësohet periodikisht për të reflektuar ndryshime ligjore ose teknologjike. Ndryshimet publikohen në faqen tonë përmes së cilës ne promovojmë transparencën për të ndërtuar besim publik.